

VENDIM
Nr.1044, datë 14.10.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS ODRIE, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Odrie, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, lipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 28 (njëzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Odrie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Odrie

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2,4,5,6,8,9,11,12,13,15,16	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
3,7,10,14,17,75,76,83,84, 89,92,95,96 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
18-23	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
24-26	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
27-29	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
30	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
31-38	Varrezat publike	Në pronësi
39-44	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
45-62 (vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
45-62 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe,lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

98-100	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
101-102	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi